



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI
Drejtoria Juridike

121
6/2/2017

SHESHI "NËNË TEREZA", REKTORATI I UT-së, TIRANË
TEL. +4 228402, FAX: +4 223981

Nr. 420/1 Prot.

Tiranë më 06.02.2017

LËNDA:

Përcillet për zbatim

DREJTUAR:

Fakultetit të Histori- Filologjisë
(të gjithë fakulteteve)

Këtu

Bashkëlidhur ju dergojmë për kompetencë shkresën nr. 749 prot. datë 30.01.2017 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, "Për miratimin e bursave nga IAL-të publike për vitin akademik 2016-2017".

Të njoftohen strukturat e brendshme të fakultetit për shtyrjen e afatit të dorëzimit të dokumentacioneve të kategorive të studenteve të përcaktuar në VKM nr. 903 datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë", deri në datën 16 shkurt 2017.

Gjithashtu, të merren masat e nevojshme për njoftimin e studentëve në portal dhe në standat e fakultetit.

REKTORI

MYNYR KONI



07/02/2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Ministri

Nr. 744 Prot.

Tiranë, më 30.12.2017

LËNDA: Për miratimin e bursave nga IAL-të publike për vitin akademik 2016-2017

DREJTUAR: UNIVERSITETIT te Tiranës (Rektorit)

I Nderuar Zoti Rektor,

Në zbatim të Vendimit nr.903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë" pika 13, ku theksohet se afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave të studentëve të viteve të dyta e të treta është data 30 dhjetor 2016, Universitetet në Tiranë si dhe IAL publike në rrethe, kanë dërguar zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit kërkesën për shtyrje të këtij afati, pasi është e pamundur paraqitja e dokumentacionit nga ana e studentëve.

Kërkesat e tyre IAL publike i argumentojnë me pamundësinë për të shpallur kriteret për aplikim, kohën e pamjaftueshme të studentëve për tu pajisur me dokumentacion vërtetues të gjendjes së tyre social-ekonomike të lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore për vitin 2016.

Referuar Urdhrit nr. 455, datë 6.9.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e datës së fillimit të vitit akademik 2016-2017 në institucionet e arsimit të lartë, studentët kanë përfunduar studimin në datën 23.12.2016 dhe janë larguar me pushimet e fund vitit 2016 dhe nuk patën mundësi për tu njohur me kriteret që kërkohen për të aplikuar për përfitimin e bursave nga institucionet publike të arsimit të lartë.

Nisur dhe nga situata epidemike e gripit në zbatim të Urdhrit nr. 10 datë 7.1.2017 të Ministrit të Shëndetësisë "Për mbylljen e kopshteve, çerdheve, institucioneve arsimore para-universitare dhe universitare", afati për fillimin e procesit akademik në IAL publike dhe ato private është shtyrë me dy javë.

Për shkak edhe të bllokimit të rrugës në disa zona të vendit si pasojë e motit të ftohtë, studentët nuk arritën të aplikonin për të përfituar bursat në vijim nga viti akademik 2015-2016, si dhe bursat e fituara sipas Vendimit nr.903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit nr.903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë", kërkojmë nga ana Juaj të rishqyrtohen dhe miratohen kërkesat e studentëve të viteve të dyta dhe të treta, edhe pas datës së përcaktuar në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave, sipas dokumentacionit të paraqitur prej tyre. Periudha për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për këto kategori, të kryhet jo më vonë se dy javë pas marrjes zyrtare të këtij njoftimi.

Faleminderit për bashkëpunimin,

LENDITA NIKOLAJ

MINISTER

